

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 1 prill 2025

Z. Erden Atiq, Kryetar
Komuna e Mitrovicës së Veriut
Lagjja e Boshnjakëve
40 000 Mitrovica Veriore

LETËR REKOMANDIMI

R.nr. 870/2024

I nderuari z. Atiq,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 23 gusht 2024 kishte pranuar ankesë nga z. Skender Sadiku, asamblist në Kuvendin Komunal të Komunës së Mitrovicës së Veriut, përkitazi me mosfunktionalizimin e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Mitrovicës së Veriut.

Në bazë të pohimeve të z. Sadikut vërehet se më 28 qershor 2021 dhe më 1 qershor 2023, Kuvendi Komunal i Komunës së Mitrovicës së Veriut kishte nxjerrë vendim, me të cilin ishte themeluar Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, por zyra nuk ishte themeluar deri në kohën kur ankuesi kishte parashtruar ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit ka analizuar çështjen në fjalë dhe ka vërejtur se Kuvendi Komunal i Komunës së Mitrovicës së Veriut kishte nxjerrë dy vendime (28.6.2021 dhe 1.6.2023), nëpërmjet të cilave kishte themeluar Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Mitrovicës së Veriut.

Në këtë drejtim, Avokati i Popullit ka analizuar Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe ka vërejtur se:

- Neni 12 [Aktet e kuvendit të komunës], paragrafi 2, shkronja (d), përcakton:

“d) çdo akt tjetër të nevojshëm apo të duhur për funksionim efikas të komunës.”

- Neni 58 [Përgjegjësitë e kryetarit], shkronja (d), përcakton:

“ekzekuton aktet e kuvendit të komunës.”

Po ashtu, Avokati i Popullit ka analizuar Rregulloren nr. 02/2010 për Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe ka vërejtur se:

- Neni 1 [Qëllimi], paragrafi 1, përcakton:

“Qëllimi i kësaj rregulloreje është që të sigurojë që komunat, në kuadër të fushëveprimit të kompetencave të tyre, dhe në bazë të nevojave të komuniteteve joshumicë që jetojnë në

territorin e tyre dhe/ose që janë banorë tradicionalë apo të përhershëm në territorin e tyre, të krijojnë struktura administrative adekuate, Zyrat Komunale për Komunitete dhe Kthim, për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e komuniteteve, qasje të barabartë për të gjitha komunitetet në shërbimet publike, si dhe dhe të krijojnë kushte për kthim të qëndrueshëm të refugjatëve, personave të zhvendosur dhe personave të riatdhesuar.”

Avokati i Popullit, duke pasur dispozitat e theksuara më sipër, konsideron se themelimi i zyrave komunale për komunitete dhe kthim është i përcaktuar me Rregulloren nr. 02/2010 për Zyrat për Komunitete dhe Kthim, të cilat luajnë rol të rëndësishëm në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve, qasjen e barabartë për të gjitha komunitetet në shërbimet publike.

Duke pasur parasysh këtë çështje, Avokati i Popullit ka vërejtur se Kuvendi i Komunës së Mitrovicës së Veriut, duke ushtruar autorizimet e tij, ka nxjerrë dy vendime, nëpërmjet të cilave ka vendosur për themelimin e Zyrës për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Mitrovicës së Veriut.

Lidhur me këtë çështje, Avokati i Popullit konsideron se kryetari i komunës, sipas përgjegjësisë të përcaktuara në Ligjin nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, përkatësisht nenit 58, është përgjegjës për ekzekutimin e akteve të Kuvendit të Komunës dhe, sipas këtij përcaktimi, kryetari i komunës së Mitrovicës së Veriut, ka qenë dhe është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të theksuara më sipër.

Avokati i Popullit thekson se themelimi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim ndikon pozitivisht në ngritjen e standardit normues në të drejtat e komuniteteve dhe rrjedhimisht moszbatimi i vendimeve të theksuara më sipër lidhur me themelimin e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim ua pamundëson komuniteteve realizimin e të drejtave të tyre të garantuara me Kushtetutë dhe me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.

Avokati i Popullit tërheq vëmendjen se institucionet e Republikës së Kosovës, e në këtë rast kryetari i komunës së Mitrovicës së Veriut e ka për detyrë të luajë rol aktiv në drejtim të krijimit të mekanizmave për realizimin e të drejtave të komuniteteve të përcaktuara me Kushtetutë dhe me legjislacionin në fuqi.

Rrjedhimisht, Avokati i Popullit i


REKOMANDON

- Kryetarit të komunës së Mitrovicës së Veriut:**

Të ndërmarrë veprime në drejtim të zbatimit të vendimit të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës së Veriut, të datës 1.6.2023, për themelimin e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim në Komunën e Mitrovicës së Veriut, përkatësisht t'i ndërmarrë të gjitha veprimet në drejtim të funksionalizimit të Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim.

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqes atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr.

05/L-019 për Avokatin e Popullit (*“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”*), ju lutemi mirësisht të na informoni për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.

Me nderime,

Naim Qelaj
Avokat i Popullit